



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 16 paragrafi 9 të Ligjit për Teatrot nr.04/L-106, Këshilli Drejtues i Teatrit të Gjiçanit, në bashkëpunim me zyrën e Kryetarit të Komunës shpall:

K O N K U R S

(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Njësia për Kulturë, Rini dhe Sport

Titulli i punës: Aktor

Nr. i pozitave: 12

Kohëzgjatja e angazhimit: Sipas kontratës për shërbime të veçanta

Paga bruto mujore: 380 €

Qëllimi i vendit të punës-angazhimit: performimi në aktivitetet e ndryshme teatrore në kuadër të Teatrit të Qytetit dhe më gjerë:

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- të mësoj tekstin dhe të mbajë prova;
- të hulumtoj dhe lexojnë material apo të ndërmarrin aktivitete fizike dhe intelektuale që të ndihmojnë në përgatitjen e rolit të tij
- të diskutoj interpretimin dhe të shfaq kreativitet dhe kolektivisht në bashkëpunim me të tjerët dhe regjisorin;
- të performoj drejtpërdrejt para publikut;
- të performoj në studio apo lokacion tjetër varësisht nga nevojat që paraqet produksioni;
- të incizoj zëra varësisht nga nevoja e produksionit;
- të kujdeset për hapësirën performuese, kostumet dhe rekuizitat;
- të mbaj mend tekstin dhe të gjitha funksionet tjera të veprës derisa ajo vepër zyrtarisht del nga repertori apo siç është e specifikuar në kontratë;
- bën përgatitjet me kohë për punën e aktorit në punën e caktuar;
- studion veprën dhe punon në mënyrë krijuese për jetësimin artistik në përpunimin dhe transpozicionimin e rolit;
- bashkëpunon drejtpërdrejt me regjisorin e shfaqjes për të rumbullaksuar rolin;

- merr pjesë në të gjitha provat e caktuara të leximit, të rregullta, teknike dhe ato kryesore;
- shfrytëzon ndihmën e skenografit, kostumografit dhe grimerit për shkoqitjen përpunuese të rolit të cilin e interpreton;
- përpunon dhe plotëson artistikisht rolet e përgaditura nëse kjo i kontribuon shtimit të kualitetit artistik të shfaqjes;
- përpos në mënyrë permanente çdo rol në shfaqjet individuale në kuadër të konceptimit të regjisorit;
- merr pjesë aktive në realizimin artistik të secilës shfaqje për të bërë zëvendësimin momental, të përkohshëm apo të plotë të aktorit tjetër në rast mungese;
- merr pjesë në të gjitha shfaqjet në kuadër të veprimtarisë normale të teatrit, si dhe në vizitat si mysafirë;
- perfeksionohet në mënyrë permanente, artistikisht dhe profesionalisht dhe ndjek literaturën dramaturgjike kombëtare dhe botërore;
- obligohet të përcjell çdo ditë repertoarin dhe orarin e aktiviteteve të teatrit për t'u njoftuar me obligimet ndaj tyre;
- obligohet që para çdo paraqitje publike të gjendet në përgaditoret e teatrit së paku një orë e gjysmë para shfaqjes, pos në rast se është përcaktuar ndryshe;
- për punën e tij i përgjigjet regjisorit, inspicientit, udhëheqësit artistik dhe drejtorit të përgjithshëm
- kryen edhe punë tjera në bazë të udhëzimeve të Drejtorisë.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- shkollimi adekuat akademik për aktor;
- të ketë së paku tri vite përvojë pune aktive në realizimin e roleve në teatër;
- të njoh gjuhën shqipe në nivel të shkëlqyer në të shkruar dhe lexuar e domosdoshme dhe gjuhët tjera zyrtare;
- njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- të ketë aftësi të mira komunikuese ndër njerëzore dhe të jetë i gatshëm të punoj me orar fleksibil të punës.

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartcekur duhet t'i kompletoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (foto kopje) si vijon :

1. dëshmi të kualifikimit shkollorë në fotokopje e nëse kandidati e ka kryer shkollimin jashtë Republikës së Kosovës diploma duhet të jetë e nostrifikuar në MASHT.
2. dëshmi mbi përvojën e punës,
3. dokumentin e identifikimit

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në arkivin qendror të Komunës së Gjilanit, përkatësisht në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve

Afati i aplikimit është **8** ditë, nga dita e shpalljes publike të konkursit në Web faqen komunale dhe tabelen e shpalljeve publike.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

Përzgjedhja e aktorëve të angazhuar do të bëhet nga komisioni profesional i emëruar nga Këshilli drejtues i teatrit përmes procedurës së audicionit.